



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

---

**RREGULLORE (ZKM) – NR.14/2024**  
**PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIMIN E**  
**VENDEVE TË PUNËS NË AGJENCINË PËR ADMINISTRIMIN E**  
**PASURISË SË SEKUESTRUAR DHE TË KONFISKUAR<sup>1</sup>**

---

<sup>1</sup>Rregullorja (ZKM) Nr.14/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar, është miratuar nga Kryeministri me Vendimin Nr. 126/2024, të dates 16.07.2024.

## **Kryeministri i Republikës së Kosovës,**

Në mbështetje të nenit 94 (10) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, bazuar në nenin 28 (paragrafi 3) të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura të Republikës së Kosovës, në përputhje me nenin 9 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.11) të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, si dhe në përputhje me nenin 9 paragrafi 7 të Rregullores QRK-Nr. 01/2020 për standardet e organizimit të brendshëm, sistematizimin e vendeve të punës dhe bashkëpunimin në institucionet e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura,

Miratton:

## **RREGULLORE (ZKM) - NR.14/2024 PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS NË AGJENCINË PËR ADMINISTRIMIN E PASURISË SË SEKUESTRUAR DHE TË KONFISKUAR**

### **KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

#### **Neni 1 Qëllimi**

Kjo Rregullore ka për qëllim përcaktimin e organizimit të brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Agjencinë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar (në tekstin e mëtejme: AAPSK).

#### **Neni 2 Fushëveprimi**

Kjo Rregullore zbatohet nga Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar.

### **KAPITULLI II ORGANIZIMI I BRENDSHËM I AGJENCISË**

#### **Neni 3 Misioni i Agjencisë**

Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar ka për mision administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar.

#### **Neni 4 Struktura organizative e Agjencisë**

1. Struktura organizative e AAPSK, është si në vijim:

1.1.Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm;

1.2. Departamentet;

1.3. Divizionet.

2. Numri i të punësuarve në AAPSK, është njëzetë e gjashtë (26).

### **Neni 5 Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm**

1. Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm, përbëhet nga:

1.1. Drejtori i Përgjithshëm;

1.2. Dy (2) nëpunës civil profesional.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit të Përgjithshëm përcaktohen me Ligjin për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, me Ligjin për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar si dhe me legjislacionin tjetër në fuqi.

3. Detyrat dhe përgjegjësitë e personelit mbështetës të Zyrës së Drejtorit Ekzekutiv përcaktohen sipas legjislacionit përkatës për zyrtarët publik.

4. Numri i të punësuarve në Zyrën e Drejtorit Përgjithshëm është tre (3).

### **Neni 6 Departamentet dhe Divizionet në kuadër të Agjencisë**

1. Departamentet dhe divizionet në kuadër të AAPSK-së, janë:

1.1. Departamenti për Trajtimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar;

1.1.1. Divizioni për pranimin dhe vlerësimin e pasurisë;

1.1.2. Divizioni për ruajtjen e vlerës së pasurisë;

1.1.3. Divizioni për shitjen e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar.

1.2. Departamenti për Trajtime Juridike, Administrimin e të Hyrave të Sekuestruara ose Konfiskuara dhe Statistikë:

1.2.1. Divizioni për çështje juridike të pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar;

1.2.2. Divizioni për administrimin e të hyrave nga pasuritë e sekuestruara ose konfiskuara dhe statistika.

### **Neni 7 Departamenti për Trajtimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar**

1.Misioni i Departamentit për Trajtimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar, është pranimi i pasurisë, vlerësimi dhe ruajtja e vlerës, shitja, dhënia me qira, dhënia në shfrytëzim, kthimi dhe asgjësimi i pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar.

2.Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit për Trajtimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar janë:

2.1.trajtimi dhe administrimi i pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar të përdorura për, apo të përfituara nga vepra penale, përfshirë pasurinë nga terrorizmi, me përjashtim të pasurisë së konfiskuar për realizimin dhe mbledhjen e detyrimeve tatimore;

2.2.vlerësimi i vlerës së pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar, si dhe përcaktimin e mënyrës së ruajtjes së kësaj pasurie;

2.3.përcaktimi i mënyrës së ruajtjes së vlerës së pasurisë në administrim;

2.4.hartimi i programit për aftësimin e zyrtarëve publik në fushën e sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurisë së përfituar me veprë penale në bashkëpunim me IKAP dhe partneret ndërkombëtar;

2.5.shitja e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar sipas vendimit të gjykatës kompetente duke derdhur të ardhurat e grumbulluara nga shitja në Buxhetin e Kosovës ose dorëzimin e pasurive për shfrytëzim nga Qeveria;

2.6.evidentimi i pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar duke mbajtur të dhënat në një sistem të centralizuar kompjuterik.

3. Drejtori i Departamentit për Trajtimin e Pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar i raporton Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar.

4. Në kuadër të këtij Departamenti, bëjnë pjesë këto divizione:

4.1.Divizioni për pranimin dhe vlerësimin e pasurisë;

4.2.Divizioni për ruajtjen e vlerës së pasurisë;

4.3.Divizioni për shitjen e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar.

5. Numri i të punësuarve në Departamentin për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar është gjashtëmbëdhjetë (16).

## **Neni 8**

### **Divizioni për Pranimin dhe Vlerësimin e Pasurisë**

1.Misioni i Divizionit për pranimin dhe vlerësimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar është pranimi i pasurisë dhe ndërmarrja e veprimeve të nevojshme për marrjen në administrim të pasurisë.

2.Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për pranimin dhe vlerësimin e pasurisë, janë:

2.1. në bazë të vendimeve gjyqësore bën pranimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar të përdorura për, apo të përfituara nga vepra penale, përfshirë pasurinë nga

terrorizmi, me përjashtim të pasurisë së konfiskuar për realizimin dhe mbledhjen e detyrimeve tatimore;

2.2. bashkëpunon dhe koordinohet me zyrtarët përgjegjës të policisë për ekzekutim të vendimit të gjykatës, që të jenë prezent gjatë pranim-dorëzimit të pasurisë, e cila ende nuk është në kontrollin e Agjencisë;

2.3. bënë vlerësimin e vlerës së pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar;

2.4. për nevoja të procedurës përcjellë lëvizjen e tregut për vlerën e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar me qëllim që çmimet e pasurive të vlerësuara të jenë të përafërta me çmimet e tregut;

2.5. harton raportet profesionale mbi vlerësimin e pasurive, duke përcjellë kështu opinionin të pavarur për vlerën e tregut të këtyre pasurive;

2.6. administron dosjet fizike dhe elektronike të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara duke bërë evidentimin e çdo ndryshimi të pasurive;

2.7. bënë organizimin e Depos dhe deponimin e pasurive të sekuestruar dhe të konfiskuar sipas llojit;

2.8. harton programin e aftësimit të zyrtarëve publik në fushën pranimin dhe vlerësimin të pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar të përfituar me vepër penale, në bashkëpunim me IKAP dhe partnerët ndërkombëtar;

2.9. mbështet ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë sipas nevojës;

2.10. mbanë evidencën dhe administrimin e të dhënave lidhur me pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara në një sistem të centralizuar kompjuterik.

3. Udhëheqësi i Divizionit për pranimin dhe vlerësimin e pasurisë raporton tek Drejtori i Departamentit për Trajtimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar.

4. Numri i të punësuarve në Divizionin për pranimin dhe vlerësimin e pasurisë është gjashtë (6).

## **Neni 9**

### **Divizioni për Ruajtjen e Vlerës së Pasurisë**

1. Misioni i Divizionit për ruajtjen e vlerës së pasurisë është kontrolli dhe ruajtja e vlerës së pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për ruajtjen e vlerës së pasurisë janë:

2.1. përcakton mënyrën e ruajtjes së pasurive në administrim nga AAPSK-së;

2.2. përcakton veprimet që do të ndërmerren për mbikëqyrjen, ruajtjen adekuate dhe sigurimin e vlerës së pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme të sekuestruar ose të konfiskuar;

- 2.3. për ruajtje të pasurisë në mënyrë sa më adekuate u bënë vizita të rregullta këtyre pasurive, dhe ndërmerret masa të nevojshme për të minimizuar rënien e vlerës së pasurive si të luajtshme ashtu edhe të paluajtshme të cilat janë nën administrim të Agjencisë.
  - 2.4. harton raporte për mirëmbajtjen e pasurive të cilat administrohen;
  - 2.5. plotëson formularët e vendosur në pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme;
  - 2.6. klasifikon automjetet sipas kategorive dhe i përgatitë ato varësisht nga vendimet e gjykatave (ruajtje, shitje, kthim apo shfrytëzim etj.);
  - 2.7. ofron këshilla dhe ndihmë administratorëve të pasurive, si dhe personelit tjetër mbi të gjitha çështjet që ndërlidhen me veprimtarinë e kësaj fushë;
  - 2.8. harton programin e aftësimit në fushën e ruajtjes së vlerës së pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar të përfituar me veprën penale në bashkëpunim me IKAP dhe partnerët ndërkombëtar.
  - 2.9. mbanë evidencë dhe bënë administrimin e të dhënave të pasurisë në ruajtje në një sistem të centralizuar kompjuterik;
3. Udhëheqësi i Divizionit për ruajtjen e vlerës së pasurisë raporton tek Drejtori i Departamentit për Trajtimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar.
  4. Numri i të punësuarve në Divizionin për vlerësimin dhe shitjen e pasurisë është pesë (5).

## **Neni 10**

### **Divizioni për shitjen e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar**

1. Misioni i Divizionit për shitjen e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar është shitja e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar. Pas vendimit për shitje, divizioni zbaton vendimin dhe fillon procedurat e shitjes ose dhënies me qira të pasurive nën administrim.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për shitjen e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar janë:
  - 2.1. shet pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara, sipas vendimit të gjykatës apo organit kompetent;
  - 2.2. kujdeset që shitja e pasurisë të mos jetë nën vlerën dhe nivelin e çmimit të shitjes në treg;
  - 2.3. përgatitë dhe koordinon procedurat për shitjen publike të pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar;
  - 2.4. koordinohet me institucionet, zyrtarët përkatës për vlerësim të pasurisë brenda Agjencisë apo ekspertët e angazhuar për vlerësimin e posaçëm profesional të pasurisë;
  - 2.5. zhvillimi i procedurave të shitjes së pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar në përputhje me legjislacionin në fuqi;
  - 2.6. pas shitjes së pasurisë së sekuestruar sipas vendimit të gjykatës, informon Gjykatën kompetente për rezultatin e shitjes;

- 2.7.ekzekutimi i vendimit të Gjykatës që t'ia ktheje pasurinë palës në procedurë;
- 2.8.merr pjesë në procesin e dorëzimit të pasurisë së konfiskuar në shfrytëzim nga Qeveria;
- 2.9.koordinon punët me zyrtarët përkatës për asgjësimin e çfarëdo pasurie, që nuk është e përshtatshme për shitje publike, sipas rekomandimeve apo këshillave të zyrtarëve dhe ekspertëve, që asgjësimi do të jetë në pajtim me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë publike;
- 2.10. ofron mbështetje teknike për të gjitha organet përgjegjëse për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore si dhe për tjetërsimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara;
- 2.11. harton programin e aftësimit në fushën e shitjes së pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar të përfituar me vepër penale në bashkëpunim me IKAP dhe partnerët ndërkombëtar;
- 2.12. ndihmon ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë;
- 2.13. mbanë evidencë dhe administron të dhënat e pasurisë së shitur në një sistem të centralizuar kompjuterik.
3. Udhëheqësi i Divizionit për shitjen e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar raporton tek drejtori i Departamentit për Trajtimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar.
4. Numri i të punësuarve në Divizionin për vlerësimin dhe shitjen e pasurisë është katër (4).

### **Neni 11**

#### **Departamenti për Trajtime Juridike, Administrimin e të Hyrave të Sekuestruara dhe Konfiskuara si dhe Statistikë**

1. Departamenti për Trajtime Juridike, Administrimin e të Hyrave të Sekuestruara dhe Konfiskuara si dhe Statistikë ka për mision trajtimin e urdhrave dhe vendimeve të gjykatës, ofrimin e këshillave për prokurorinë, gjykatën dhe institucionet tjera mbi natyrën specifike të procesit të administrimit të pasurisë.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit për Trajtime Juridike, Administrimin e të Hyrave të Sekuestruar dhe Konfiskuar si dhe Statistikë janë:
- 2.1.trajton urdhrin e gjykatës për masën e përkohshme për sigurimin e pasurisë, aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës sipas legjislacionit në fuqi;
- 2.2.koordinon me departamentin përkatës në ofrimin e ndihmës juridike ndërkombëtare për të gjitha rastet që përfshijnë pasurinë e sekuestruar dhe konfiskuar, duke administruar pasurinë e sekuestruar apo konfiskuar në bazë të kërkesës së bërë nga një shtet tjetër;
- 2.3.ofron këshilla për Prokurorinë, Gjykatën dhe institucionet tjera mbi natyrën specifike të procesit të administrimit të pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar, me qëllim të ofrimit të ndihmës për planifikimin sekuestrimeve, apo konfiskimeve të mundshme;

2.4.mbanë evidencë për vendimet gjyqësore të trajtuara në të cilat është vendosur për pasurinë e sekuestruar dhe të konfiskuar si dhe memorandumet e bashkëpunimit të lidhura me organet partnere dhe institucionet;

2.5.bënë administrimin dhe gjenerimin e mjeteve nga të hyrat e konfiskuara, depozitat, shitja përmes ankandave publike, dhënia me qira e pasurive të sekuestruar, dhe të konfiskuara, si dhe parave kesh në koordinim me Departamentin operacional;

2.6.mbledh dhe përpunon të dhënat statistikore që ndihmojnë në hartimin, zbatimin dhe rishikimin e Planit Zhvillimor të Agjencisë apo dokumenteve tjera në nivel të Agjencisë.

3.Drejtori i Departamentit për trajtime juridike, administrimin e të hyrave të sekuestruar dhe konfiskuar si dhe statistikë, i raporton Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë

4.Në kuadër të këtij Departamenti bëjnë pjesë këto divizione:

4.1.Divizioni për trajtime juridike të pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar; dhe

4.2. Divizioni për të hyra nga pasuria e sekuestruar dhe konfiskuar si dhe statistikë.

5. Numri i të punësuarve në Departamentin për Trajtime Juridike, Administrimin e të Hyrave të Sekuestruara dhe Konfiskuara si dhe Statistikë është shtatë (7).

## **Neni 12**

### **Divizioni për trajtime juridike të pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar**

1. Divizioni për trajtime juridike të pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar ka për mision pranimin, shqyrtimin, procedimin e urdhrave të gjykatës, si dhe ofrimin e këshillave për prokurorinë, gjykatën dhe institucionet tjera mbi natyrën specifike të procesit të administrimit të pasurisë.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për trajtime juridike të pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar janë:

2.1. trajton urdhrin e gjykatës për masën e përkohshme për sigurimin e pasurisë, aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës sipas legjislacionit në fuqi;

2.2. koordinohet me Departamentin operacional në ofrimin e ndihmës juridike ndërkombëtare për të gjitha rastet që përfshijnë pasurinë e sekuestruar dhe konfiskuar, duke administruar pasurinë e sekuestruar apo konfiskuar në bazë të kërkesës së bërë nga një shtet tjetër.

2.3. ofron këshilla për Prokurorinë, Gjykatën dhe institucionet tjera mbi natyrën specifike të procesit të administrimit të pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar, me qëllim të ofrimit të ndihmës për planifikimin sekuestrimeve, apo konfiskimeve të mundshme;

2.4. përgatitë lëndët për dorëzim në prokurori, dhe harton vendimet për shitjen e pasurive në fazën e sekuestrimit për pasurinë që është e zëvendësueshme dhe mund të humbë vlerën në rast të magazinimit ose nëse vlerësohet se shpenzimet e magazinimit janë jo proporcionale me vlerën e pasurisë së sekuestruar;



2.5. bashkëpunon me gjykata dhe prokurori apo institucione tjera me qëllim të plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për pasuritë në administrim;

2.6. mbanë evidencë për vendimet gjyqësore të trajtuara në të cilat është vendosur për pasurinë e sekuestruar dhe të konfiskuar si dhe memorandumet e bashkëpunimit të lidhura me organet partnere dhe institucionet.

3. Udhëheqësi i Divizionit për trajtime juridike të pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar, raporton tek Drejtori i Departamentit për Trajtime Juridike, Administrimin e të Hyrave të Sekuestruara dhe Konfiskuara si dhe statistikë.

4. Numri i të punësuarve në Divizionin për trajtime juridike të pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar është tre (3).

### **Neni 13**

#### **Divizioni për administrimin e të hyrave nga pasuria e sekuestruar ose konfiskuar dhe statistikë**

1. Misioni i Divizionit për të hyra nga pasuria e sekuestruar dhe konfiskuar dhe statistikë është administrimi, gjenerimi i mjeteve nga të hyrat e konfiskuara dhe depozitat e sekuestruara si dhe mbledhja dhe përpunimi i të dhënave statistikore.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për administrimin e të hyrave nga pasuria e sekuestruar ose konfiskuar dhe statistikë janë:

2.1. bën evidentimin e të gjitha të hyrave dhe raportimin e gjendjes së të hyrave;

2.2. bën gjenerimin e mjeteve nga të hyrat e konfiskuara dhe depozitat e sekuestruara që administrohen nga AAPSK;

2.3. bën administrimin e të hyrave të sekuestruara dhe të konfiskuara nga parat kesh, shitja përmes ankandëve publike si dhe nga qiraja e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara në bashkëpunim me Departamentin për Trajtimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar;

2.4. bën barazimin e të hyrave të sekuestruara dhe të konfiskuara me thesarin në periudha mujore;

2.5. mjetet nga depozitat e sekuestruara nga parat kesh, nga shitja përmes ankandëve publike nga qiraja e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara administrohen sipas Ligjit, mjetet në të holla mbahen në një llogari të veçantë të Agjencisë deri në momentin kur vendimi bëhet i formës së prerë;

2.6. bën lëshimin e faturave të qerasë për pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara, përcjelljen e pagesave bazuar në kontratat e qirasë, lëshimin e faturave për deponimin e parave kesh si dhe lëshimin e faturave për shitje përmes ankandëve publike.

2.7. mbledhë të dhëna statistikore që ndihmojnë për hartimin, zbatimin dhe rishikimin e Planit Zhvillimor të Agjencisë apo dokumenteve të tjera të Agjencisë;

2.8. koordinimi dhe bashkërendimi për përputhjen e të dhënave të Agjencisë duke u bazuar në statistikat reale;

2.9. ofron të dhëna statistikore për çështje që ndërlidhen me sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive.

2.10. ofron të dhëna statistikore dhe raporte analitike si dhe këshilla të ndryshme për mundësi të ndryshme që lidhen me fushëveprimin e Agjencisë;

2.11. hartimi i raporteve me të dhënat statistikore për pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara.

3. Udhëheqësi i Divizionit për administrimin të hyrave nga pasuria e sekuestruar ose konfiskuar si dhe statistikë raporton tek drejtori i Departamentit për Trajtime Juridike, Administrimin e të Hyrave të Sekuestruara ose Konfiskuara si dhe Statistikë.

4. Numri i të punësuarve në Divizionin për të hyra nga pasuria e sekuestruar, konfiskuar si dhe statistikë është tre (3).

#### **Neni 14** **Dispozitat përfundimtare**

1. Lëvizja e personelit në pajtim me legjislacionin për zyrtarët publik brenda institucionit është e lejuar, nëse konsiderohet e nevojshme për mbarëvajtjen e punës.

2. Rritja apo zvogëlimi i numrit të personelit në pajtim me Ligjin Vjetor të Buxhetit nuk krijon nevojë për plotësim ndryshimin e kësaj rregulloreje, përveç në rastet kur krijohen dhe/apo shuhet strukturat organizative.

3. Pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje është Shtojca nr.1 e cila përmban numrin e përgjithshëm të të gjithë të punësuarve në Agjenci dhe numrin e veçantë për secilën njësi, si dhe Shtojca nr.2 e cila përmban organogramin vizual.

#### **Neni 15** **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

\_\_\_\_\_  
**Kryeministër i Republikës së Kosovë**

**16 korrik 2024**

**Shtojca Nr.1 – Klasifikimi dhe sistematizimi i vendeve të punës**

<b>Struktura</b>	<b>Pozita</b>	<b>Kategoria dhe Klasa</b>	<b>Grupi i pozitave</b>	<b>Numri i ekzekutuesve</b>
1. Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm	Drejtori i Përgjithshëm	Drejtues i Lartë	N/A	1
	Zyrtar i Lartë Ekzekutiv	Profesional 1	63. Grupi i Administrimit të Përgjithshëm	1
	Zyrtar administrativ	Profesional 3	64. Grupi i Administrimit të Përgjithshëm	1
			<b>Total</b>	<b>3</b>
2. Departamenti për Trajtimin e Pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar	Drejtor i Departamentit	Drejtues i Mesëm	N/A	1
2.1.Divizioni për pranimin dhe vlerësimin e pasurisë	Udhëheqës i Divizionit	Drejtues i Ulët	N/A	1
	Zyrtar i lartë për pranimin e pasurisë	Profesional 1	12. Grupi i Shkencave Shoqërore	3
	Zyrtar i Lartë për vlerësimin e pasurisë	Profesional 1	12. Grupi i Shkencave Shoqërore	2
			Total divizioni	6
2.2.Divizioni për ruajtjen e vlerë së pasurisë	Udhëheqës i Divizionit	Drejtues i Ulët	N/A	1
	Zyrtar i Lartë për vlerësimin e pasurisë	Profesional 1	63. Grupi i Administrimit të Përgjithshëm	1
	Zyrtar për mirëmbajtje dhe ruajtje të pasurisë	Profesional 2	63. Grupi i Administrimit të Përgjithshëm	1

	Zyrtar për mirëmbajtjen e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar	Profesional 2	63. Grupi i Administrimit të Përgjithshëm	1
	Zyrtar i Lartë i Teknologjisë Informative	Profesional 1	49. Grupi i Teknologjisë Informative	1
			<b>Total Divizioni</b>	<b>5</b>
2.3. Divizioni për shitjen e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar	Udhëheqës i Divizionit	Drejtues i Ulët	N/A	1
	Zyrtar i Lartë për shitjen e Pasurisë	Profesional 1	63. Grupi i Administrimit të Përgjithshëm	2
	Zyrtar për shitjen e pasurisë	Profesional 2	63. Grupi i Administrimit të Përgjithshëm	1
			<b>Total Divizioni</b>	<b>4</b>
			<b>Total Departamenti</b>	<b>19</b>

3. Departamenti për Trajtime Juridike, Administrim të të Hyrave të Pasurisë së Sekuestruar, të Konfiskuar si dhe Statistikë	Drejtor i Departamentit	Drejtues i Mesëm	N/A	1
3.1 Divizioni për Trajtime Juridike të Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar	Udhëheqës i Divizionit	Drejtues i Ulët	N/A	1
	Zyrtar i Lartë Ligjor	Profesional 1	1. Grupi Ligjor	1
	Zyrtar Ligjor	Profesional 2	1. Grupi Ligjor	1
			<b>Total Divizioni</b>	<b>3</b>
3.2.Divizioni për administrim të të hyrave të pasurisë së sekuestruar, konfiskuar si dhe statistikë	Udhëheqës i Divizionit	Drejtues i Ulët	N/A	1
	Zyrtar i Lartë për administrim të të hyrave	Profesional 1	2. Grupi i Buxhetit dhe Financave	1
	Zyrtar i Lartë Financiar dhe Statistike	Profesional 1	2. Grupi i Buxhetit dhe Financave	1
			<b>Total Divizioni</b>	<b>3</b>
			<b>Total Departamenti</b>	<b>7</b>
	<b>Total numri i përgjithshëm i pozitave në Agjenci</b>			<b>26</b>

Shtojca Nr. 2 – Organogrami

